

Në datën 04.12.2023 në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës është hedhur shorti për zgjedhjen e Anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojnë përgjatë vitit 2024. Të pranishëm për të vëzhguar shortin e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të këtij organi të pavarur ishte Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, përfaqësues të tjerë të lartë të institucioneve shtetërore kushtetuese, institucioneve të drejtësisë, si dhe përfaqësues të OPDAT dhe Delegacionit të BE-së në vendin tonë.

9 anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në mandatin e tyre njëvjeçar do të kenë përgjegjësinë për vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

9 anëtarët e KED për vitin 2024 janë:

1. Elsa Toska, Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese
2. Sonila Bejtja, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese
3. Sokol Ngresi, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë
4. Alma Muça, Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
5. Irena Brahimi , Gjyqtar në Gjykatat e Apelit
6. Altina Nasufi, Gjyqtar në Gjykatat e Apelit
7. Lazer Çardaku, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
8. Genti Xholi, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
9. Ramiz Lala, Gjyqtar nga Gjykatat Administrative

6 anëtarët zëvendësues të KED për vitin 2024:

1. Marjana Semini, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese
2. Darjel Sina, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë
3. Arqilea Koça, Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
4. Iliriana Olldashi, Gjyqtar në Gjykatat e Apelit
5. Irma Balli, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
6. Bezart Kaçkini, Gjyqtar nga Gjykatat Administrative
